

PANO  
ÇUKA

Urdhëroni  
në vendlindjen  
time

BIBLIOTEKA  
SHTETIT

8114-1

E 92




vjersha e poeme

PANO ÇUKA

URDHËRONI  
NE  
VENDLINDJEN  
TIME...

Vjersha e poemë



SHËTËPIA BOTUESE «NAIM FRASHËRI»

## SKËNDERBEU

Nga shekujt na fanitesh, Skënderbe,  
mbi atin këmbëshpejtë e luftethinjur,  
me shpatën tënde madhështore çveshur;  
ish tringëllima e saj-kuj' e armiqve,  
shkëlqimi i saj — shkëlqimi i fitores.

Dhe ati hingëllin siç hingëllinte  
dhe atëhere kur i shpoje brinjët  
që të lëshohej nër betejat flakë,  
kufomat duke shkelur që i ngjanin  
atkosit korrur fushës nga ajo shpatë  
që i ka hije burrit;

se mëshira  
kundrejt armikut, dobësinë ka motër.

Gjokset-lëmenj të trimave të tu —  
shtrënguar pran' e pranë, që të ndjejnë

rrahjet tokmak të zemrës së shojskokut,  
ngritën bedenat e një lloj kështjelle  
që s'ishte parë dhe kishte si kurorë  
gjoksin tënd leshtor dhe erërrahur.

Asqerët e armiqve atje shëmbeshin,  
siç shëmben valët mbi shkëmbenjt e bregut;  
thyheshin, ulërinin të përgjakur,  
suleshin prapë e thyheshin sërish.  
Edhe gjakosja e tyre ish çdo herë  
më e rëndë e më i thellë turpi i tyre.  
E sa më poshtë merrnin rrokullimën  
ato hordhi, me turp, nëpër humnera,  
aqë më lart lavdia jote ngjitej  
në eterin që s'i gjendet fund e anë.

Pa po u bë ajo legjendë e këngë,  
ninull' e ëmbël e foshnjave në djep,  
kushtrim i zjarrtë, një trumbetë zgjimi  
që gjuhësh të panumërta jehonte,  
se ti i kishe këmbët të rrënjosura  
në tokën amëtare, kurse shpata,  
që vringëllinte në mejdan të luftës,  
kryet e osmanllive duke korrur,  
priste dhe lakun që për aqë popuj  
gati e kish bërë vdekja e pabesë.

Me frymëmarrjen e shqiptarve, Skënderbe,  
dhe ata popuj merrnin frymë!  
Mbi gjoksin burrëror të shqiptarit  
— kështjellë e pamposhtur e lirisë —  
u mek vërshim i trubullt i errësirës.

Në ata gjokse gjete ti lirinë,  
në ata gjokse gjete ti thëngjillin  
dhe flakën ndeze zjarr të trimërisë;  
në ata gjokse gjete ti besimin,  
që kush e ka nuk jepet asnjëherë:  
«Në qoftë, the, se unë s'do jem më  
populli është i madh e nuk vdes kurrë.  
Cilindo past armik s'do ta pushojë  
luftën por me hov të ri do të fitojë!»

Me atin tënd, që ngrihet sipër dheut,  
shekujt do shoqërosh, o Skënderbe.  
Lavdia fluturon pas teje dhe mban  
plloskën me verën gjak të heroizmit,  
qeras me të çdo brez e plloska prapë  
qëndron e mbushur plot me verën tënde!

## DUEL ME VDEKJEN

*Shqiptari e ban dekën si me le.*

Populli

Mesnatë...

Fashistët si rrebesh  
u derdhën në gelinë e myshkët.  
Ai — një i vetëm, buzëqesh.  
Ata — një turmë, vështrojnë me frikë.

Ecën...

Ai bën të fundmet çape  
dhe shkel i sigurt e krenar.  
Ata do kthehen të gjallë prapë,  
por dridhen sikur venë në varr.

Shulet e pushkëve zhurmuan,  
vrapuan fishekët në foletë.

Ata — lëvizën të shqetësuar.  
Ai — qëndron përballë i qetë.

Befas, një zë në errësirë  
jehoi si një krismë e thatë:  
— Thua, a ke ndonjë dëshirë  
para se të të përpijë kjo natë?

— Po — u tha trimi.

Dhe xhelatët  
i mbajtën veshët si qen gjuetie.  
«Mos vallë e trembi varri i hapët?  
Mos vallë në gjunjë do të bie?»

— Dua — vazhdoi ai — një krehër  
të kreh pak flokët që m'u prishën;  
si në ditë feste, porsi dhendër  
drejt vdekjes sot dua të nisem.

Gjëmuan pushkët. . .

Por më shumë  
gjëmuan ato të pakta fjalë.

Erdhën e u frynë si një furtunë  
e tundën fushë e tundën malë.

Armiqtë, të zverdhur, ulën kryet.  
Nata u bë sterrë, mbytëse, e ftohtë.  
Tërë dritën trimit ja dhanë yjet,  
era vrapoi t'i krihte flokët...



## VARGJE PËR HEROIN

*Thodhori Mastorës*

Me flokë të shpupuritur kur sulej në beteja,  
— i pari porsi shkrepëtimë që lajmëron furtunën —  
thua sikur hakmarrja vetë shtatin e tij po mirrte  
e shqipet trimin komunist me admirim vështronin.  
Dhe kur betejat mirrnin fund e batalioni çlodhej,  
si shatërvan të qeshurat i derdhte komandanti.  
Qafuhej me shokët ngrohtësisht dhe dridhte me ta  
vallen.

Kur fliste, sikur ndjente pranë hapin e vetë fitores.  
Dhe kur në ballë një plumb armik e gjeti dhe e rrëzoi,  
i hapi duart si dy flatra të përfaqonte tokën.  
Gjaku i dliurë si trëndafilë u hap nëpër dëborë.  
S'kish lule më të bukura lirinë të përshëndeste.

## BALLADË PËR NJË TUFË FLOKËSH

*Kur të vizitoni muzeun e Gjir  
rokastrës vëreni me kujdes një  
tufë flokësh të heroinës Perse-  
foni Kokdhima...*

Një tufë flokësh sollën një ditë në muze.  
Dhe na flasin flokët; (ç'ne se s'kanë zë?)

Vetëm dorë e nënës i kish përkëdhelë  
ata flokë të butë, në shami mbështjellë.

Dhe vetëm Liria, atje lart në mal,  
i pat shpupuritur flokët me ngadalë.

Kurrë ndonjë furqetë me gurë të çmuar  
ata flokë të artë s'i kish zbukuruar.